


AKT THEMELIMI


I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"INGENIUM" Sh.p.k

Ida Ivanaj


Leure Hoxha


Tiranë, 2022

Robert Gjergjaj


PASQYRA E LËNDËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË.....	2
AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE	2
“INGENIUM” SH.P.K.	2
KREU I - THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA	2
Neni 1 - Themeluesit.....	2
Neni 2 – Forma Ligjore	2
Neni 3 – Baza Ligjore	2
Neni 4 – Objekti i Veprimtarisë	2
Neni 5 – Kohëzgjatja e Veprimtarisë.....	3
Neni 6 – Zyra qendrore.....	3
KREU II - KAPITALI.....	4
Neni 7 – Kapitali Themeltar.....	4
KREU II – ORGANET E SHOQËRISË (VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE)	5
Neni 8 – Asambleja e përgjithshme.....	5
Neni 9 – Administratorët, Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet	6
KREU IV – VITI FINANCIAR. EKSPERTËT. BILANCI.....	9
Neni 10 – Viti Financiar dhe Fitimi	9
KREU V – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	10
Neni 11 – Dispozita të përgjithshme.....	10
Neni 12 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	10
Neni 13 - Dispozita Përfundimtare.....	10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

"INGENIUM" SH.P.K.

KREU I - THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1 - Themeluesit

Sot më datë 01.11.2022 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "INGENIUM" Sh.p.k, mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", si dhe ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Themeluesit e shoqërisë janë:

Unë Ida Ivanaj, shtetase shqiptare, e bija e Zefit, lindur me 08.10.1995 në Lezhë dhe banuese në Lezhë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal J56008024U, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Unë Rezeart Zgjanjoli, shtetas shqiptar, i biri i Pertefit lindur më 09.10.1977 në Durrës dhe banues në Durrës, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal H71009040U, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar,

Unë Lorenc Verçani, shtetas shqiptar, i biri i Feritit, lindur me 11.07.1990 në Librazhd dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal J00711016C, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Neni 2 – Forma Ligjore

Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (këtu e tutje Sh.p.k), në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 – Baza Ligjore

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ("Ligji i Shoqërive Tregtare").

Neni 4 – Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj:

Projektim, Mbikëqyrje për vepra civile dhe infrastrukture. Instalime hidrosanitare, furnizime uji, kolektorë shkarkimi, ujësjellës-kanalizime, vepra ujitje dhe kullimi, diga dhe damba. Vepra të trajtimit të ujit, vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi. Studime urbanistike, projektim i objekteve

civile, industriale, turistike, edhe me shkallë të lartë vështirësie në fushën e ndërtimit. Projektim dhe vlerësim qëndrueshmërie në troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët. Projektim i plotë në fushën e infrastrukturës, rrugë, autostrada, helioporte, aeroporte, hekurudha, ura dhe vepra arti, estakada, ura metalike, tunele etj. Studim dhe vlerësim mbi rrezikun dhe riskun sizmik, vulnerabiliteti në fushën e inxhinierisë sizmike. Mbikëqyrje dhe kolaudim i të gjitha punimeve në ndërtim.

Neni 5 – Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar.

Neni 6 – Zyra qendrore

1. Shoqëria e ka zyrën qendrore të saj në rrugën Rr. "Gjon Nikollë Kazazi", Ndërtesa Nr. 17, Selitë, Tiranë;
2. Administratori, në përputhje me kompetencat që i jep ky Statut mund të regjistrojë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktivitetin e përcaktuar në Nenin 3 "Objekti i veprimtarisë".
3. Shoqëria vendos në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë adresat elektronike si në vijim info@ingeniumpld.com dhe admin@ingeniumpld.com. Faqja zyrtare e shoqërisë është www.ingeniumpld.com.



KREU II - KAPITALI

Neni 7 – Kapitali Themeltar


1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 15,000.00 lek (pesëmbëdhjetë mijë lekë).
2. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 pjesë (kuota), njëra pjesë me vlerë nominale 5,001.00 lekë (pesëmijë e një lekë), dhe dy pjesët mbetëse me vlerë nominale secila prej 4,999.50 lekë (katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë pikë 5 lekë).
3. Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:
 - Ida Ivanaj, zotërues i 33.33 % të kapitalit të shoqërisë;
 - Rezeart Zgjanjulli, zotërues i 33.34 % të kapitalit të shoqërisë;
 - Lorenc Verçani, zotërues i 33.33 % të kapitalit të shoqërisë;
4. Zmadhimi/zvogëlimi/ndryshimi i kapitalit nuk do të ndryshojë pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, pavarësisht kontributit të secilit, përveçse kur të gjithë ortakët janë dakord.
5. Parashikimet për pikat si në vijim por nuk kufizohet në to, rregullohen në Statutin e Shoqërisë:
 - a) Zmadhimi i Kapitalit
 - b) Zvogëlimi i Kapitalit
 - c) Transferimi i Kapitalit. Kufizimet mbi Transferimin



KREU II – ORGANET E SHOQËRISË (VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE)

Neni 8 – Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
3. Çdo ortak ka të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshëm të ortakëve ("Asambleja e Ortakëve"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.
4. Vetëm Asambleja e Ortakëve, vetëm me shumicë 3/3 e votave, do të ketë të drejtën të vendosë për çështjet e mëposhtme:
 - d) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - e) ndryshimet e statutit;
 - f) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - g) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - h) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - i) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - k) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - l) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - m) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - n) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - o) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - p) të themelojë dhe/ose të mbyllë degë dhe përfaqësi brenda dhe jashtë Shqipërisë;
 - q) të vendosë mbi pagën e Administratorit
 - r) të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të shoqërisë'
 - s) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
5. Statuti i Shoqërisë përcakton procedurën e veprimtarisë dhe marrjen e vendimeve nga Asambleja e Përgjithshme por nuk kufizohet në veprimtaritë në vijim:
 - a) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Ortakëve;
 - c) Përfaqësimi në asamble;
 - d) Kuorumi i Asamblesë së Ortakëve, Marrja e vendimeve;
 - e) Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve;
 - f) E drejta e Votës dhe Përrjashtimi nga e Drejta e Votës



Neni 9 – Administratorët, Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare, kundrejt palëve të treta dhe shtetit;;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - i) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - j) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pas miratimit me shkrim nga ortakët;
 - k) nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj., pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - l) vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori nuk duhet ta kalojë shumën e 5.000,00 EUR (pesë mijë euro) (ose 500.000,00 ALL (pesë qind mijë lekë)), për lëvizjen e shumave më të mëdha se vlerat më lart kërkohet miratimi i ortakëve të shoqërisë;
 - m) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
 - n) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pas miratimit me shkrim nga ortakët;
 - o) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj. Administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
 - p) administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësorë, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimin por në çdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

- q) përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - r) thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
 - s) të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për te hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet fax-it, postës elektronikë apo postës së zakonshme.
 - t) Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e ortakëve sipas nenit 11 të këtij Statusi (Për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme).
 - u) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht, dhe në mënyrë të pavarur shoqërinë. Çdo administrator ka kompetenca të plota të veprave të vetëm në interes të shoqërisë, duke realizuar detyrat e administratorit.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me vendim të ortakëve 3/3. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
5. Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për të arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.
6. Personat e mëposhtëm do të caktohen si Administratorë të Shoqërisë për një afat 3 vjeçar:

Znj. Ida Ivanaj, shtetase shqiptare, e bija e Zefit, lindur me 08.10.1995 në Lezhë dhe banuese në Lezhë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal J56008024U,

nënshkrimi





Z. Rezeart Zgjanjoli, shtetas shqiptar, i biri i Pertefit lindur më 09.10.1977 në Durrës dhe banues në Durrës, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal H71009040U,

nënshkrimi



Z. Lorenc Verçani, shtetas shqiptar, i biri i Feritit, lindur me 11.07.1990 në Librazhd dhe banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet pasaportës me Nr. Personal J00711016C,



nënshkrimi

Louise Bergami 

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, në këtë Statut, vendimet e Asamblesë se Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.



KREU IV – VITI FINANCIAR. EKSPERTËT. BILANCI

Neni 10 – Viti Financiar dhe Fitimi

1. Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.
2. Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave të nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri, sipas nenit 76 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
3. Tërheqja, shpërndarja e fitimit ndërmjet ortakëve apo në çdo rast likuidimi ndaj ortakëve, do bëhet në mënyrë të tillë, që nuk ndikon në gjendjen e kompanisë, të paktën për 6 muaj, (shpenzimet/paga/detyrime minimalisht për 6 muaj të jenë në llogarinë financiare të shoqërisë).
4. Eksperti Kontabël, Bilanci dhe Mbajtja e Llogarisë së veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë përcaktohen sipas parashikimeve në Statutin e Shoqërisë.



KREU V – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11 – Dispozita të përgjithshme

Shoqëria përcakton nëpërmjet Statutit të saj parashikimet në rastet kur në objektin e veprimtarisë së saj do të ndeshet me situata si në vijim por nuk kufizohet në:

- a) Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë;
- b) Riorganizimi i Shoqërisë. Bashkimi-Ndarja;
- c) Marrëdhëniet e Punës;
- d) Ndryshime në Statut;

Neni 12 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 13 - Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare "INGENIUM" Sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"INGENIUM" Sh.p.k

Znj. Ida IVANAJ

Z. Rezeart ZGJANJOLLI

Z. Lorenc VERÇANI